Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/225
Datë: 29.04.2022

Në mbështetje të nenit 1, 2, dhe 4 të Ligjit nr. 03/L-060, Ligji për Kualifikimet Kombëtare i datës 7 nëntor 2008, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 44 / 22 dhjetor 2008), nenit 12 të Ligjit nr. 04/L-138 për Arsim dhe Aftësim Profesional, Udhëzim Administrativ Nr.28/2014 për kriteret dhe procedurat për verifikimin e standardit të profesionit, neni 5, pika 1.4, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 29.04.2022 mori vendim për miratimin:

Rregullorja Nr.01/225 për caktimin dhe vazhdimin e vlefshmërisë së afateve të standardeve kombëtare të profesionit

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e afateve të Standardeve Kombëtare të Profesionit (tash e tutje SKP).

2. Gjithashtu, përmes kësaj rregulloreje do të definohen procedurat për caktimin dhe zgjatjen e afatit të vlefshmërisë për SKP.

3. Kjo rregullore do të definoj formën dhe mënyrën e komunikimit të AKK dhe zhvilluesve të SKP.

Neni 2

Përkufizimet

STANDARDET janë tregues të matshëm të të arriturave, që caktohen sipas kritereve kualitative ose kuantitative dhe duhet të arrihen nga kandidatët, që duan të kualifikohen.

STANDARDET E PROFESIONIT pasqyrojnë realizimin e punës e cila zbërthen shkathtësitë për të realizuar me sukses funksionet e kërkuara të një profesioni si dhe aplikimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencat në një profesion.

APROVIMI - nënkupton procesin nëpërmjet të cilit autoriteti përkatës i njeh standardet. Aprovimi jepet për një periudhë të caktuar.

AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE (AKK) - është organ i pavarur i krijuar me ligj, i cili ka hartuar Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe ka për qëllim rregullimin e Sistemit të Kualifikimeve Kombëtare (Ligji për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, nëntor 2008).

KORNIZA KOMBËTARE E KUALIFIKIMEVE (KKK) - është mekanizëm kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve të dhëna brenda sistemit kombëtar të kualifikimeve, sipas një grupi të kritereve që i përcaktojnë nivelet dhe llojet e rezultateve të mësimit.

SISTEMI I KUALIFIKIMEVE - nënkupton sistemin e plotë brenda të cilit jepen dhe certifikohen kualifikimet, që përfshijnë kornizën kombëtare të kualifikimit dhe dispozitat ligjore për rregullimin e dhënies së kualifikimeve.

KËSHILLI DREJTUES I AKK (KD i AKK) - përbën 13 anëtarë dhe që përfaqësojnë ministritë relevante, universitetet publike, partnerët social, organizatat joqeveritare dhe ofrues privat, të cilët kanë përgjegjësi për politikat zhvillimore dhe vendimmarrjen lidhur me KKK-në.

EKSPERTËT E AKK - anëtarët e brendshëm të AKK të cilët kanë përgjegjësi për zhvillimin dhe zbatimin e politikave lidhur me KKK si dhe zhvillimin, koordinimin dhe mbarëvajtjen e proceseve të verifikimit të standardeve të profesionit, validimit, akreditimit, akreditimit të NjMP dhe monitorimit të IAAP.

EKIPET E EKSPERTEVE – anëtaret e jashtëm të panelit verifikues të angazhuar nga AKK sipas listës së miratuar nga KD i AKK për t'u përfshirë në procesin e verifikimit të standardeve të profesionit.

IAAP - do të thotë çdo institucion që ofron, vlerëson dhe certifikon kualifikime të arsimit dhe aftësimit profesional dhe për të rritur.

Neni 3

Informimi i palëve të interesit nga AKK

1. Me qëllim të informimit të palëve të interesit të cilat kanë zhvilluar SKP, AKK bënë publike të gjitha procedurat dhe kriteret të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesit për të proceduar më tutje lidhur me vlefshmërinë e SKP.

2. Për çdo ndryshim të procedurave apo kritereve AKK bën njoftim zyrtar për të gjitha palët e interesit.

Neni 4

Afatet e Standardeve Kombëtare të Profesionit

1. SKP të cilat nuk kanë afat të përcaktuar me vendim nga KD i AKK, do të zhvillohet procedurë për caktimin e afatit të vlefshmërisë.

2. SKP të cilave u skadon afati i përcaktuar me vendim nga KD i AKK, do të zhvillohet procedurë për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë.

3. SKP të cilat shpallen si të pavlefshme, do të zhvillohet procedurë për shpalljen e pavlefshme.

4. SKP e pavlefshme do të largohen nga databaza e SKP pas njoftimit në faqen zyrtare të AKK

Neni 5

Procedura për caktimin e vlefshmërisë së afatit të SKP

1. Nëse SKP nuk kanë një afat të vlefshëm me vendim nga KD i AKK, AKK do të inicoj që të iu përcaktohet afati i ri i vlefshmërisë.
2. AKK do të:
   2.1. Njoftoj zhvilluesin e SKP për skadimin e afatit;
   2.2. Kërkoj nga zhvilluesi i SKP për të shqyrtuar në rast se SKP ka pësuar ndryshime dhe e njëjta të ndryshohet edhe në përmbajte të SKP;
      2.2.1. në rast se zhvilluesi i SKP konsideron se SKP ka nevojë për ndryshime atëherë e njofton AKK
      2.2.2. AKK me pranimin nga zhvilluesi se SKP ka nevojë për ndryshime obligohet që të filloj procedurat për procesin e riverifikimit të tyre.
   2.3. AKK do të bëjnë publike në faqen zyrtare të AKK afatin dhe nevojat e ndryshimit të SKP;

Neni 6

Njoftimi për vlefshmërinë e afatit të SKP

1. Njoftimi për vlefshmërinë e afatit do të bëhet nëpërmjet njoftimit zyrtar nga AKK.
2. Afati për ndryshimin e përmbajtjes ose propozimet nga zhvilluesi i SKP do të jetë 10 ditë punë nga data e njoftimit.
3. AKK do të paraqesin në faqen zyrtare të AKK njoftimin për nevojat për ndryshim të SKP në të njëjtën kohë kur njoftohet edhe zhvilluesi.
4. Nëse zhvilluesi i SKP nuk kthen përgjigje për plotësim ndryshimet e kërkuara, sipas afatit të caktuar, AKK procedon përmes raportimit vazhdimin e vlefshmërisë së SKP edhe për një afat tjetër.

Neni 7

Plotësim ndryshimet e SKP

1. Zhvilluesi i SKP duhet të njoftoj me shkrim AKK nevojat për plotësim ndryshim apo rekomandimet nëse ka.

2. Kërkesat për ndryshim duhet të jenë të arsyetuara dhe të bazuara në dëshmi dhe analizën e tregut të punës.
3. Nëse ka kërkesë për plotësim ndryshim të SKP, atëherë AKK inicion procedurat e ri verifikimit të SKP nga ekipet verifikuese sipas legjislacionit në fuqi.
4. Nëse ka informata nga tregu i punës se SKP i caktuar nuk përputhet me kërkesat

5. Pas procesit të ri verifikimit, KD i AKK aprovon SKP sipas legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Dispozitat përfundimtare

1. Ne rastet kur kjo rregulloreje bie ndesh me dispozitat e tjera ligjore, apo Udhëzimet Administrative të cilat e rregullojnë fushën ku vepron AKK, atëherë përparësi do tu jepet dispozitave ligjore, dhe udhëzimeve administrative te cilat e rregullojnë këtë fushë.

2. Kjo rregullore mund të ndryshohet nga Këshilli Drejtues, me propozimin e Drejtorit të AKK-së, me qellim të përshtatjes se dispozitave ligjore në fuqi, apo avancimin e standardeve, dhe kritereve te cilat aplikohen nga AKK.

3. Pas miratimit të kësaj rregulloreje, AKK do t'i informoj të gjitha palët e interesit, dhe te njëjtën do ta bëjë publike ne ueb faqen e AKK-së, me qellim të informimit të të gjitha palëve të interesit.

Neni 9
Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn ne fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit nga ana e Këshillit Drejtues të AKK-së.

Prishtinë, 29.04.2022

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK